



01/ Nr.303/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, neni 5 pika 1.1, neni 6 pika 1.2, neni 7 pika 1.1, neni 8 pika 1.1 dhe neni 14 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 11 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

#### VENDIM-PARAPRAK

#### PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS VITIN 2026

1. Miratohet propozimi i kryetarit të komunës për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2026. Pronat të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim janë:

Nr. rendor	Nr. i parcelës	Zona kadastrale	Vendi i quajtur:	Sip.m2	Kultura	Destinimi
1.	73317070-00927-0	Pustenic	Nikona	11710	arë e kl. 8	Bujqësi-Blegtori
2.	73317070-00946-0	Pustenic	Tanask	8906	kullosë e kl. 4	Bujqësi-Blegtori
3.	73317073-00792-0	Rezhancë	Ortica	19461	Kullosë e kl. 6	Bujqësi-Blegtori
4.	73317073-00789-1	Rezhancë	Gjuri	9510	Kullosë e kl.5	Bujqësi-Blegtori

2. Parcelet e lartshënuara do të jepen në shfrytëzim palëve të interesuara me qëllim të shfrytëzimit efektiv të pronës së paluajtshme të Komunës, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes nxitjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në vendbanimet rurale të Komunës.

3. Parcelet e lartshënuara janë të destinuara për zhvillim të aktiviteteve bujqësore: mbjellje të kulturave të ndryshme bujqësore, aktiviteteve nga fusha e blegtorisë: shfrytëzim si kullosa, ngritje të minifermave dhe aktivitete të ngajshme.

4. Parcelet e lartshënuara do të jepen në shfrytëzim për një periudhë kohore afatgjatë që nënkupton periudhën kohore prej 15 vite deri në 99 vite me një çmim fillestar prej 100 €/ha për vit.

5. Dhënja në shfrytëzim do të bëhet përmes ankandit publik sipas procedurave të përcaktuara me rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

6. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë zyra ligjore e Kryetarit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë e Bujqësisë dhe stafin ndihmës të Komunës.

7. Ky vendim paraparak hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.01.2026





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.304/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 nenit 11, 12.2 shkronja (d), 40, Statuti i Komunës neni 24, Rregullorja për Organizimin e Kompetencave dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale 01/Nr.7113/2012 e datës 31.10.2012 neni 4, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

**V E N D I M**  
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PËR VITIN 2026

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026.
2. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2026 përmban aktivitete dhe objektivat e punës së ekzekutivit të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:29.01.2026





01/Nr.307/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, nenit 17 pika 2, lidhur me pikën 6 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 11 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

#### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTIZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Mitatohet propozimi i kryetarit të komunës për formimin e komisionit vlerësues me rastin e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë (15-99 vite) të pronave të paluajtshme të komunës sipas listës së veçantë- përmes procedurave të hapura të ankandit publik.
2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve si në vijim:
  - 2.1. Nexhmedin Daci - anëtar i komisionit- përfaqësues nga ekzekutivi i komunës,
  - 2.2. Abduraman Bushi -anëtar i komisionit-përfaqësues nga ekzekutivi i komunës,
  - 2.3. Shefket Lusnjani-anëtar i komisionit-përfaqësues nga kuvendi i komunës,
  - 2.4. Ibadete Kuka- anëtare e komisionit-përfaqësues nga kuvendi i komunës,
  - 2.5.Mevlane Kalisi-anëtare e komisionit- përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë të përcaktuar në Ligjin për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës të përfshira në listën e veçantë të pronave të planifikuara për dhënje në shfrytëzim vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës, anëtarët e komisionit dhe zyra e prokurimit të komunës Hani i Elezit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës Hani i Elezit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 29.01.2026





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr.308/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 paragrafi 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.01.2026





01/Nr.309/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, nenit 18 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 11 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

#### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURËN E DHËNJES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet propozimi i kryetarit të komunës për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës përmes ankandit publik.
2. Komisioni ankesave përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. Arbenita Bajramaliu - anëtare e komisionit- përfaqësues nga ekzekutivi i komunës,
  - 2.2. Majlinda Kaloshi - anëtare e komisionit-përfaqësues nga ekzekutivi i komunës,
  - 2.3. Nora Xhoni - anëtare e komisionit-përfaqësues nga kuvendi i komunës,
  - 2.4. Hanumshahe Dibrani-anëtare e komisionit-përfaqësues nga kuvendi i komunës,
  - 2.5. Endrit Ballazhi - anëtar i komisionit përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Kryesuesi i komisionit të ankesave zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të komisionit.
4. Detyrat dhe përgjegjësi e komisionit të ankesave nga neni 1 i këtij vendimi janë të përcaktuar në Ligjin për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Komisioni shqyrton të gjitha ankesat e paraqitura nga palët, kthimin e përgjigjeve Brenda afatit ligjor, nxjerrjen e vendimeve lidhur me ankesat dhe raportimin.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës, anëtarët e komisionit dhe zyra e prokurimit të Komunës Hani i Elezit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në uebfaqen e Komunës Hani i Elezit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 29.01.2026





01/Nr.313/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 5, 12.2 shkronja (d), 14, 17, Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-87, neni 5 pika 2 si dhe Ligjeve për ndryshim dhe plotësim të këtij Ligji, Nr.04/L-111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr.05/L-009 të vitit 2015, Statutin e Komunës neni 11. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

**VENDIM  
PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE**

1. Miratohet përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale për menaxhimin e mbeturinave NPL "Pastrimi".
2. Komisioni komunal i aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina NPL "Pastrimi" përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve, një anëtarë i emëruar nga Kryetari i Komunës, dy anëtarë të emëruar nga kuvendi i komunës,
  - 2.1. Sevime Bajrami -anëtare e emëruar nga Kryetari i Komunës,
  - 2.2. Resul Suma-anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës,
  - 2.3. Hanumshahe Dibrani-anëtare e emëruar nga Kuvendi i Komunës
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me numër 01/Nr.413/2022, i datës 27.01.2022 për përbërjen e komisionit komunal të aksionarëve.
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 577/2026

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026 merr:

**VENDIM**

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2026

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:29. 01. 2026

